

**Nr. 2303/25 K (e-k) Prot.**  
**Tiranë, më datë 07/04/2023**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Anëtarëve të Komisionit Rregullator

**Lënda:** REKOMANDIM – Lidhur me  
garantimin e një mjedisi të lirë  
dhe të pandikuar ndaj zgjedhësve  
në afërsi të qendrave të votimit  
gjatë Ditës së Zgjedhjeve.

**I Nderuar z. Komisioner!**

**Të nderuar Anëtarë të Komisionit Rregullator!**

**Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!**

Në kuadër të gjithë bashkëpunimit të deritanishëm me Institucionin e KQZ-së, për të cilin gjejmë rastin t'ju falënderojmë sërish, **KRIIK ju nis këtë rekomandim për plotësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator, në zbatim të nenit 109, pika 5 e 6 të Kodit Zgjedhor, lidhur me garantimin e një mjedisi të lirë nga intimidimi, të pandikuar, të qetë dhe të sigurt për zgjedhësit gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe mundësinë që zgjedhësit të votojnë të lirë e në mënyrë të fshehtë.**

Ky rekomandim është në vazhden e komunikimit dhe shqetësimit të përcjellë verbalisht me ju dhe me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, si një gjetjet më shqetësuese të monitorimit të zgjedhjeve të 25 prillit 2021 dhe 6 marsit 2022.

Si raporti i KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin e 25 prillit 2021, ashtu edhe ai i OSBE/ODIHR kanë evidentuar si problematike prezencën e personave të paautorizuar, në pjesën dërrmuese aktivistë apo militantë të subjekteve zgjedhore, në afërsi të qendrave të votimit, qofshin këto mjediset e përbashkëta mes qendrave të votimit në strukturat publike (oborr apo korridore), apo menjëherë në afërsi të tyre (pranë hyrjes) gjatë ditës së zgjedhjeve.

Prania e aktivistëve partiakë rreth qendrave të votimit mund të përbëjë një kërcënim madhor potencial për fshehtësinë e votës. Kjo për shkak se aktivistët partiakë së bashku me mbështetësit e tyre, vetëm me praninë e tyre apo edhe me veprime konkrete ushtrojnë ndikim apo edhe mund të frikësojnë zgjedhësit, gjë që mund t'i bëjë votuesit të ndihen të ndikuar apo detyruar të votojnë për një kandidat ose parti të caktuar, apo edhe të mos shkojnë fare në votim për shkak të dekonspirimit të shkuarjes së tyre për të votuar.

Këto praktika të evidentuara jo rrallë në gati tërë proceset zgjedhore të mëparshme, krijojnë një mjedis armiqësor apo frikësues për votuesit, gjë që mund t'i bëjë ata të ndihen së paku jo komodë apo edhe të frikësuar për të votuar lirisht, në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar në asnjë formë.

Praktika e militantëve partiakë të grumbulluar në afërsi të qendrave të votimit është veçanërisht problematike nëse shihet në kontekstin më të gjerë të strukturave të organizuara për drejtimin e votës në periudhën parazgjedhore, nëpërmjet sistemit të

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

patronazhimit politik dhe kontrollit kapilar të votuesve; përfshi por pa u kufizuar në blerjen e votës apo intimidimin e zgjedhësve.

Një sistem i tillë i kontrollit dhe drejtimit të votës, i cili në gjykimin e KRIIK përbën një shkelje të pikës b të nenit 25 Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Politike të Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>, ratifikuar prej Shqipërisë që prej vitit 1991, përmbillet ditën e zgjedhjeve me prezencën e personave të paautorizuar në afërsi të qendrave të votimit.

Për sa më sipër, të Nderuar Kolegë të KQZ-së, na lejoni t'ju rikthejmë në vëmendje se rekomandimi i dytë parësor i OSBE/ODIHR në Raportin Final për Zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit 2021 ka qenë se “[s]hteti duhet të garantojë të drejtën për një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë. Çdo formë presioni për të zbuluar nëse dikush ka votuar apo jo dhe si ka votuar duhet të parandalohet.”<sup>2</sup>

Për më tepër, prezenca e grupeve të aktivistëve apo militantëve partiakë në afërsi të qendrave të votimit mund të kthehet edhe në një rrezik potencial për konflikte ditën e zgjedhjeve, reale apo artificiale, duke krijuar një situatë pasigurie akoma më të theksuar dhe dekurajuar pjesëmarrjen e lirë në zgjedhje të qytetarëve.

Bazuar në problematikën e parashtruar më sipër, **KRIIK gjykon se kjo çështje do të duhet të adresohet në mënyrë të menjëhershme dhe sa më shteruese nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nxit Trupat Drejtuese të KQZ-së që të ndërveprojnë për ta adresuar atë dhe garantuar një situatë ku zgjedhësit mund të ndiejnë se votojnë të lirë dhe në mënyrë të fshehtë; jo vetëm brenda qendrave të votimit, por edhe në mjediset rrethuese të tyre, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor<sup>3</sup>.**

Në gjykimin e KRIIK, një nga mënyrat për të minimizuar efektin e këtij fenomeni, përsa i përket manifestimit të tij në Ditën e Zgjedhjeve, do të ishte që **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të përgatitë dhe nxjerrë një apo disa akte nënligjore, në formën që KQZ-ja e gjykon më të përshtatshme, për të rikthyer në vëmendjen e administratës zgjedhore në nivelin e dytë dhe të tretë se detyrimi i tyre për të garantuar një mjedis të lirë nuk përfundon tek hyrja e qendrës së votimit, por shtrihet edhe në mjedisin rrethues të saj.**

Një formë e *sugjeruar* për të garantuar këtë qëllim, mund të ishte që të ngarkohen komisionet e qendrave të votimit me detyrimin eksplicit që, në mënyrë periodike të kontrollojnë nëse mjedisi rrethues i qendrës së votimit është i qetë apo ka prezencë të personave të paautorizuar në afërsi të tyre. Në rast se evidentohet prezenca e të tillë personave, të ndërmerren hapat përkatës, në përmbushje të pikës 7 të nenit 109 të Kodit Zgjedhor, të tillë si njoftimi i Policisë së Shtetit, apo edhe ndërprerja e votimit, në rast se është e nevojshme.

Në mënyrë që të garantohet se ky detyrim nuk do të anashkalohej nga ana e komisionerëve, për shkak të njohjes apo ndërveprimit të tyre me personat e partisë respektive që ata përfaqësojnë, **sugjerohet vendosja e detyrimit ligjor për Komisionet e Qendrave të Votimit për të raportuar në mënyrë periodike në KZAZ edhe për situatën përreth qendrave të votimit.**

Nga ana tjetër, **KZAZ-të të kenë detyrimin që këtë raportim t’ia përcjellin periodikisht KQZ-së dhe, në raportimet e veta për median dhe publikun në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja të raportojë herë pas here edhe për situatën përreth qendrave**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

**të votimit, duke denoncuar rastet e prezencës së personave të paautorizuar të evidentuar dhe hapat e ndërmarre për normalizimin e situatës.**

Gjithashtu *sugjerohet* që të ngarkohen **Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)** për të qenë të vëmendshme gjatë ditës së zgjedhjeve për raportime nga mediat apo indicie nga vëzhguesit, qofshin ata të partive politike apo vëzhgues qytetarë. Në rast se KZAZ-ja merr indicie për prezencë të personave të paautorizuar në afërsi të qendrave të votimit, **të ketë detyrimin eksplicit që të dërgojë një përfaqësues të saj në qendrën apo qendrat e votimit ku është vërejtur fenomeni dhe të marrë masat e nevojshme për normalizimin e situatës.**

Nga ana tjetër, në mënyrë që mekanizmi të funksionojë do të duhet që Policia e Shtetit të kuptojë qartë e drejtë fenomenin dhe shkeljet ligjore që përmban në vetvete ai, përpos praktikës së paligjshme të ndjekur deri më tani në proceset e mëparshme zgjedhore, si dhe jetë më e vëmendshme dhe të ketë një qasje më proaktive ndaj këtij fenomeni.

KRIIK gjykon se kjo mund të arrihet nëpërmjet një **koordinimi më të mirë mes administratës zgjedhore dhe Policisë së Shtetit, në të gjithë nivelet**, nga KQZ, KZAZ e KQV.

KRIIK nxit Komisionin Qendror të Zgjedhjeve **të ndërveprojë paraprakisht, përpara hartimit e miratimit të aktit rregullator, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe me Strukturën e Përkohshme për Zgjedhjet Vendore të 14 majit** të ngritur nga Prokurori i Përgjithshëm, për të adresuar sa më mirë këtë fenomen.

Është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje së pari mënyrave për parandalimin e tij, por edhe ndërhyrjes së menjëhershme dhe procedimit penal të menjëhershëm të të gjithë individëve të cilët shkelin kuadrin rregullator ligjor për zgjedhjet si dhe parashikimet e Kreut X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve" të Kodit Penal.

**Sigurisht që në këtë rregullim është shumë e rëndësishme që gjatë kryerjes së detyrës, efektivët e Policisë së Shtetit të manifestojnë dhe tregojnë profesionalizëm të lartë duke gene prezent gjithandej dhe kontrolluar territorin, por sa më pak vizibël për publikun.** Kjo sjellje në mënyrë që, **prezenca e përqëndruar e tyre në afërsi të qendrave të votimit, të mos ketë efektin e kundërt duke krijuar një situatë pasigurie** si pasojë e forcave të shtuara të policisë, e dekurajuar tashmë, nga ana tjetër, pjesëmarrjen në zgjedhje të qytetarëve.

Në vijim të gjithë sa më sipër, rekomandohet që KQZ-ja **t'i dërgojë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit një Kujtesë të Posaçme** për detyrat e saj gjatë ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë dhe theksuar nevojën për të garantuar një mjedis të lirë në afërsi të qendrave të votimit, apo edhe nxitur, në bashkëpunim me OSBE e partnerë të tjerë ndërkombëtarë, seanca të posaçme trajnimi për drejtuesit lokalë të Policisë së Shtetit.

Së fundmi, KRIIK rekomandon që KQZ-ja t'i drejtohet edhe **partive politike dhe kandidatëve që garojnë me një Kujtesë të Posaçme** ku t'u tërheqë vëmendjen për praktikën e mëparshme të evidentuara me prezencën e aktivistëve dhe militantëve të vet në afërsi të qendrave të votimit gjatë ditës së zgjedhjeve, dhe **t'u kërkojë që të garantojnë shmangien e pranisë së këtyre personave në afërsi të qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve, përfshirë këtu paligjshmërinë e skuadrave të tyre që, në**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

## **ndërveprim me komisionerët në qendrat e votimit apo vëzhguesit e tyre politikë, monitorojnë e ndjekin se kush qytetar shkon në qendër votimi e voton.**

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

**Me konsideratë,**

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim  
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo  
Kryetar**

---

<sup>1</sup> Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Politike, Neni 25

Çdo qytetar ka të drejtën dhe mundësinë, pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: [...]

(b) Të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje të vërteta periodike, të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe do të mbahen me votim të fshehtë, duke garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; ...

<sup>2</sup> Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021, faqe 30.

<sup>3</sup> Neni 109, pikat 6 dhe 7 të Kodit Zgjedhor:

“... 6. Në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave, përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar. Përgjashtimisht nga ky rregull, lejohet prania e vëzhguesve dhe përfaqësuesve të medias së autorizuar, si dhe e personave të ngarkuar me kryerjen e sondazheve për votimin, kur organizata që ata përfaqësojnë është autorizuar për këtë qëllim nga KQZ-ja. Intervistimi i votuesve për llogari të sondazheve bëhet në rrethinat e jashtme të ndërtesës, në vendintervistimi me shenja të qarta dalluese dhe shpjeguese dhe pa penguar në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak kalueshmërinë dhe hyrje-daljen e lirë të zgjedhësve në qendrën e votimit.

7. Prezenca e personave të tjerë, jashtë parashikimeve të këtij neni, në mjediset ku kryhet administrimi zgjedhor apo në rrethinat e tyre është shkak për pezullimin e procesit dhe për të kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin. Ndërhyrja e Policisë së Shtetit bëhet sipas procedurave të miratuara nga KQZ-ja dhe dokumentohet në detaje nga administrata zgjedhore.”

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania